

Përkthimi me telefon

Për rastet kur një përkthyes ballë për ballë nuk është në dispozicion, shërbimet mund të kontaktojnë një përkthyes me telefon ose të rezervojnë një përkthyes me video.

Përkthimi me telefon është gjithashtu i dobishëm për takimet që priten të jenë të shkurtra ose ku pritet të jenë me vonesë.

Detajet e kontaktit të Shërbimit të përkthimit

Telefoni:
020 7288 3226/5191/5114/5224

Email:
whh-tr.interpreting-services@nhs.net

Ne mirëpresim komentet për shërbimin tonë dhe do të hetojmë çdo ankesë në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë.

Shërbimi i këshillimit dhe ndërlidhjes me pacientët (PALS)

Nëse keni një kompliment, ankesë ose shqetësim, ju lutemi kontaktoni ekipin tonë PALS në 020 72885551 ose whh-tr.PALS@nhs.net. Nëse keni nevojë për një kopje me germa të mëdha, audio ose të përkthyer të kësaj fletushke, ju lutemi dërgoni email në whh-tr.patient-information@nhs.net. Ne do të përpiqemi më të mirën për të përmbushur nevojat tuaja.

[Twitter.com/WhitHealth](https://twitter.com/WhitHealth)
[Facebook.com/WhittingtonHealth](https://facebook.com/WhittingtonHealth)

Whittington Health NHS Trust
Magdala Avenue
London
N19 5NF
Phone: 020 7272 3070
www.whittington.nhs.uk

Date published: 20/04/2023
Review date: 10/02/2025
Ref: Gen/InterpServ/5-Alb

© Whittington Health
Please recycle



Shërbimet e përkthimit

(Interpreting Service – Albanian)



Udhëzues për pacientët



Nëse nuk flisni anglisht, keni vështirësi të kuptoni gjuhën angleze ose jeni të shurdhër, mund ta përdorni shërbimin e përkthimit kur të keni takim. Ky shërbim është në dispozicion për klinikat ambulatorë të spitaleve, repartet, departamentin e urgjencës dhe shërbimet e bazuara në komunitet.

Përkthyesit janë aty për të komunikuar në mes të pacientëve dhe profesionistëve të kujdesit shëndetësor. Pa një profesionist të trajnuar siç duhet, ju duhet të mbështeteni te një anëtar i familjes ose një mik dhe kjo mund të rrezikojë konfidencialitetin tuaj ose saktësinë e informacionit të shkëmbyer midis jush dhe profesionistit shëndetësor.

Përkthyesit kanë një trajnim të veçantë dhe janë të përkushtuar ndaj një kodi praktikë, që do të thotë se ata do të:

- Përkthejnë gjithçka që thuhet si nga pacienti ashtu edhe nga profesionisti shëndetësor;
- Përdorë të folur të drejtpërdrejtë, kështu që komunikimi është midis pacientit dhe profesionistit;
- Respekton konfidencialitetin e të gjithë informacionit të diskutuar gjatë konsultimit;
- Siguron informata te kulturës për të ndihmuar pacientin të shprehë nevojat dhe për të siguruar që pacienti të marrë një shërbim të përshtatshëm;
- Janë të paanshëm.

Rezervimi i përkthyesit

Kur bëni ose ju jepet një takim, ju lutemi thuaj profesionistit shëndetësor se do t'ju duhet një përkthyes. Ju duhet t'i tregoni atij/asaj saktësisht se çfarë gjuhe dhe dialekti ju nevojitet. Anëtar i stafit do të kërkojë më pas një përkthyes ballë për ballë, me telefon ose video.

Përkthyesit nuk i lejohet të marrin rezervime direkt nga klinikat, stafi ose pacientët. Të gjitha rezervimet duhet të organizohen përmes zyrës së shërbimeve të përkthimit.

Fatkeqësisht, ne nuk mund të garantojmë që të ofrojmë një përkthyes në më pak se tre ditë njoftim. Për gjuhë të shenjave, ne kërkojmë një njoftim minimum prej tre javësh.

Nëse dëshironi, mund të specifikoni një përkthyes të veçantë. Ne do të përpiqemi të ofrojmë këtë përkthyes, megjithëse nuk mund ta garantojmë këtë çdo herë.

Ju duhet të siguroni:

- Emrin tuaj (ose emri i pacientit, nëse jeni duke rezervuar një përkthyes për dikë tjetër), numrin e spitalit/NHS dhe numrin e kontaktit;
- Emri dhe numri i telefonit të kontaktit të profesionistit shëndetësor me të cilin është caktuar takimi;
- Gjuha që kërkont;
- Ora, data dhe kohëzgjatja e takimit;
- Ku po mbahet takimi dhe ku duhet të raportojë përkthyesi;
- Çdo informacion shtesë që mendoni se i nevojitet shërbimit ose përkthyesit

Anulimet

Është shumë e rëndësishme që shërbimi i përkthimit të njoftohet për çdo anulim ose ndryshim në takimet e pacientëve me njoftim adekuat. Ne kërkojmë të paktën 48 orë njoftim për anulim.